

**STATUT  
I SHOQERISE "NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k.**

**DISPOZITA TE PERGJITHESHME**

Shoqeria me perjegjesi te kufizuar "**NOVA SOLAR SYSTEM**" sh.p.k. , eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruar nga ortaket e saj bazuar ne "**Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"**";

**KREU I  
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1  
DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot, më 04/06/2021 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Shoqeria do te emerohet "**NOVA SOLAR SYSTEM**" sh.p.k.

- Themelues i shoqërisë është **Shoqeria "Nova Construction 2012" shpk**, ne cilesine e ortakut te vetem qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 100%.
- Forma e shoqerise eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar

**NENI 2  
OBJEKTI I SHOQERISE**

Shoqeria ka per objekt kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqipetar.

Me konkretisht por pa u kufizuar ne to, shoqeria "**NOVA SOLAR SYSTEM**" sh.p.k. ka per objekt:

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektike fotovoltaik, dhe gjithe llojeve te tjera te prodhimit te energjise dhe veprave ndihmese ne Bashkin Bilisht, Bashkin Sarande, Bashkin Fier dhe ne gjithe territorin e Shqiperise. Prodhim Energjje Fotovoltaik, Hidrike, Solare, etj. Shit-Blerje Energjje Fotovoltaik, Solare, Hidrike, etj.

Import Eksport te te gjitha llojeve te materialeve dhe transport .

Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licencave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise.

Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj aktiviteti te parasikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes.

**NENI 3**  
**ADRESA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete Seline e saj ne Tirane, Rruga "Kajo Karafili", pasuria 2/423+1-6, vol.41, faqe 16.

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

**NENI 4**  
**KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar, periudhe e cila mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**NENI 5**  
**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 45,000,000 Lekë (dyzete e pese milion). Pjesmarrja e themeluesit ne shoqerine eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku themelues: **Shoqeria "Nova Construction 2012" shpk**, zoteron 1 kuote me vleren 45,000,000 Lekë (dyzete e pese milion) qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise. Kontributi eshte ne para ne vleren 45,000,000 Lekë (dyzete e pese milion).

Kapitali i shoqerise do te levrohet nga oratku ne nje numer llogarie bankare te shoqerise, menjeher me kerkese te administratorit, sipas projekteve dhe planit te miratuar.

**NENI 6**  
**ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Mbledhja e asamblese se ortakeve eshte organi vendimmarres per rritjen dhe zvogelimin e kapitalit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë, por vete ortaku pranon rivlersimin e pjeses se tij takuese ne shoqeri ne porpcion me rritjen e kapitalit .

Zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



## **NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit tē një shoqërie me përgjegjësi tē kufizuar e tē drejtat që rrjedhin prej tyre mund tē fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër tē parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht tē transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE, DREJTUESE DHE STRUKTURORE TE SHOQERISE**

### **NENI 8 ORGANET VENDIM-MARRESE DHE DREJTUESE TE SHOQERISE**

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhteme:

1- Asambleja e Ortakeve te Shoqerise

2- Administratori

**Asambleja e Ortakeve** eshte organi me i larte vendimarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme ne perputhje me nenin 10 dhe 11 te statutit:

- a) përcaktimin e politikave tregtare tē shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe tē ekspertëve kontabël tē autorizuar;
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" tē kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit tē politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raporteve tē ecurisë se veprimitarisë;

- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarja e fitimit/humbjes vjetore;
  - g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- m) njeherazi mund te vendoset mbi lejimin ose marrjen pjese (hyrjen) ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Ortaket mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

## **NENI 9**

### **MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 5 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **NENI 10**

### **KUORUMI**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se tre te katerat ose 75% te numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.



Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE**

Asambleja e përgjithshme vodos me 75% ose me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës ceshtjet e me poshteme:

1. për ndryshimin e statutit
2. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
3. shpërndarjen e fitimeve
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, sipas nenit 10 pika 1, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## **NENI 12 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

## **NENI 13 ADMINISTRIMI**

- 1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë per një afat 5 vjecar nga data e rregjitrimit te kesaj shoqerie prane QKB-se.

➤ **Z. Ilir SHTUFI, atesia Xhemal, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 13.10.1973 dhe banues ne Tirane, Rruga Kajo Karafili, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal H31013090C madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 45%.**

## **NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori eshte organi drejtues i shoqerise i cili ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme, te kryeje te gjitha veprimet bankare me cdo banke te nivelit te dyte, pa asnje kufizim ;
- b) përfaqësojë shoqerinë tregtare, te nenshkruaje kontrata ,noteriale ose jo, apo cdo lloj akti tjeter te domosdoshem qe lidhet me aktivitetin e shoqeriser pa kufizim;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisi dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhuar për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori eshte I detyruar te therasi Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **NENI 15** **PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“

1.) administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprime e meposhteme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

- c) u shperndan aktivet e shoqerise;
- ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne base te gjendjes financiare duhet te parashikohej qe shoqeria nuk kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) jep kredi;

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **KREU IV** **VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

##### **NENI 16** **VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

##### **NENI 17** **EKSPERTET**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrta e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### **KREU V** **PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

##### **NENI 18** **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";



e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 19 RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare."

#### **NENI 20 BAZA LIGJORE**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërítë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **NENI 21 MOSMARRËVESHJET**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

#### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

**"NOVA CONSTRUCTION 2012" Shpk**

*Perfaqesuar nga*

**Enea Kaci**  
  
NIPT: 180004019D  
NOVATO 2012  
REPUBLICA ALBANIA

Data 04.06.2021

## AKT THEMELIMI

**Shoqëria "NOVA CONSTRUCTION 2012" Shpk** e rregjitruar si person juridik, me seli në Tiranë Njësia Bashkiake Nr.10, "Rruga "KAJO KARAFILI", mbrapa ish lidhjes së shkrimtarëve, pallati Nr.14 i shoqërisë MC Inerte, pajisur me Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) L22404012D, me Administrator **Z.ENEA KACI**, i biri i Andreas i datëlindjes 08.07.1991, lindur dhe banues në Tiranë, identifikuar me Kartë e Identitetit Nr.J10708091E, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

*Shoqeria me lart e cila eshte rregjitruar si person juridik, mbeshtetur ne ligjin Nr.9901, dt.14/04/2008, "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne legjislacionin shqiptar ne per gjithesi, vendosen si vijon:*

### Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

#### Neni 1

Te themelojne shoqerine me perjegjesi te kufizuar, per te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqeria eshte person juridik shqiptar, veprimtaria e te ciles rregullohet nga akt themelimi, statuti i saj dhe legjislacioni shqipetar ne fuqi.

#### Neni 2

Shoqeria do te emertohet "**NOVA SOLAR SYSTEM**" sh.p.k.

#### Neni 3

Shoqeria do te kete Seline e saj ne Tirane, Rruga "Kajo Karafili", pasuria 2/423+1-6, vol.41, faqe 16.

#### Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Afati mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakut.

Shoqeria "**NOVA SOLAR SYSTEM**" sh.p.k gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin e QKB-se.

#### Neni 5

Shoqeria "**NOVA SOLAR SYSTEM**" sh.p.k do te kete si objekt:

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektike fotovoltaike dhe gjithe llojeve te tjera te prodhimit te energjise dhe veprave ndihmese ne Bashkine Bilisht,

Bashkin Sarande, Bashkin Fier dhe ne gjithe territorin e Shqiperise. Prodhim Energie Fotovoltaik, Hidrike, Solare, etj. Shit-Blerje Energje Fotovoltaik, Solare, Hidrike, etj. Import Eksport te te gjitha llojeve te materialeve dhe transport.

Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licencave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise.

Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj aktiviteti te parasikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes.

### **Neni 6**

Selia e shoqerise mund te transferohet.

### **Neni 7**

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfitojne ortaket e saj.

Ortaket themelues perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se saj te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Bankat e Shtetit Shqiptar.

Kapitali themeltar per vazhdimin e aktivitetit te shoqerise eshte ne shumen 45,000,000 Leke (dyzete e pese milion), qe i takon ortakut themelues si me poshte:

**Shoqëria “NOVA CONSTRUCTION 2012” Shpk** zoteron 1 kuote, me vlore 100 % te kapitalit.

Fitimet qe do te evidentohen pas miratimit te bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakeve pas zbritjes se taksave mund te ndahen si vijon:

- Fondi rezerve.
- Shperblimi qe i takon ortakeve themelues.

### **Neni 8**

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

### **Neni 9**

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

### **Te drejtat dhe detyrat e Ortakut:**

**Ortaku gezon keto te drejta kryesore:**

### **Neni 10**

- Administrimin e veprimtarise ne perputhje me akt themelimin dhe statutin.
- Pjesmarrjen ne rezultatet e çdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne statutin e saj.

- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese dhe organet e tjera te shoqerise.
- Te heqe dore nga shoqeria, heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaquesuesit te tij ose vete.
- Te emeroje dhe te shkarkoje perfaquesuesit e tij, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

#### **Ortaku ka keto detyrime kryesore:**

- Te depozitoje kuoten e tij dhe kuoten suplementare ne perputhje me akt themelimin dhe statutin.
- Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata.
- Ti japi shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e çdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Ka detyrimin nese heq dore nga shoqeria ti njoftojne vendimin e tij asamblese 3 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes.
- Te kryeje sherbimet e domosdoshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

### **ADMINISTRIMI**

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakut.

#### **Neni 11 Administratori**

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj i Pergjithshem.  
Ne shoqerine "**NOVA SOLAR SYSTEM**" sh.p.k administrator i shoqerise do te jete:

- **Z. Ilir SHTUFI**, atesia Xhemal, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 13.10.1973  
dhe banues ne Tirane, Rruga Kajo Karafili, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal  
H31013090C madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vjetesh financiare.

Me miratimin e ortakeve mund te emerohen administratore dhe perfaquesues te tjere te shoqerise "**NOVA SOLAR SYSTEM**" sh.p.k Administratoret emerohen per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori eshte perjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.



**Neni 12**  
**Mbyllja e Shoqerise**

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga ortaku, kur gjate tre vjeteteve nuk rezulton rentabel si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise.

Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

**Neni 13**  
**Kur shoqeria likujdohet**

Asambleja e ortakut emeron likujdatorin, dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te filialeve te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

**Neni 14**

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakut.

Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**“NOVA CONSTRUCTION 2012” Shpk**

Perfaqesuar nga

**Enea Kaci**

